



Npi – 01/483 datë:26.12.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për mbledhjen e mbajtur më: 26.12.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

**I VAZHDIMIT TË MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE
MIRËQENIE SOCIALE**

E mbajtur më datën: 26.12.2023 (e martë) në ora 09:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesja: znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli dhe z.Gëzim Haxhiu.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit znj.Besarta Musliu-Spahija, për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 30.08.2023 dhe 30.11.2023,
2. Informat e përgjithshme nga DSHMS-ë,
3. Formimi i komisionit për hartimin e Planit të Punës të KSHMS-së për vitin 2024,
4. Vizitë pune nga anëtarët e KSHMS-së në QKMF,
5. Të ndryshme.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për rendin e ditës, propozoj që pika e 4 të hiqet nga rendi i ditës sepse nuk kemi qka me diskutu.

z.Gëzim Haxhiu; Përshëndetje edhe , unë jam dakord me rendin e ditës të propozuar.

z.Hasan Avdyli; Përshëndetje, po pajtohem me rendin e ditës me propozimin e Kryesues edhe pse Komiteti qenka i mangët.

***Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi rendin e ditës pa pikën 4. “Vizitë pune nga anëtarët e KSHMS-së në QKMF” si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Proces. nga mbledhjet e mbajtura më 30.08.2023 dhe 30.11.2023,
2. Informat e përgjithshme nga DSHMS-ë,
3. Formimi i komisionit për hartimin e Planit të Punës të KSHMS-së për vitin 2024,
4. Të ndryshme.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 30.08.2023 dhe 30.11.2023

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për këtë pikë.
z.Hasan Avdyli; Nuk kam vërejtje.

***Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me datë: 30.08.2023 dhe 30.11.2023.**

Pika 2

Informat e përgjithshme nga DSHMS-ë

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për këtë pikë. Drejtorin, nuk e kemi prezent mirëpo nesër do ta paraqesim këtë qështje në Kuvend.

z.Gëzim Haxhiu; I bashkangjitem kërkesës së Kryesues që ta paraqesim në Kuvend.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Unë propozoj që ta bëjmë një rekomandim për ekzekutivin për të marrë pjesë drejtori në mbledhjet e KSHMS.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e -VIII- të mbajtur më 26.12.2023, unanimisht vendosi që t'i Rekomandoi Kryetarit të Komunës që të vendosë, përkatësisht të obligojë për pjesmarrjen e Drejtorëve që kanë pika të rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjet e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**

Pika 3

Formimi i komisionit për hartimin e Planit të Punës të KSHMS-së për vitin 2024

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Hasan Avdyli; Propozoj që të jetë grupi i njejtë punues sepse nuk kemi vërejtje.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Unë po kërkoj që edhe ti Hasan me marrë pjesë në takim dhe me na ndihmuar në aspektin social sepse ke përvojë.

z.Hasan Avdyli; Pajtohem që plani i punës të reduktohet në gjashtë muaj mirëpo nuk po di sa janë temat që kanë qenë e të cilat duhet me i reduktuar në gjashtë mbledhje.

z.Gëzim Haxhiu; Pajtohem me komisionin e vjetër.

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në mbledhjen e -VIII- për vitin 2023, të mbajtur më: 26.12.2023, unanimisht, zgjodhi Komisionin për hartimin e Planit të Punës të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2024, prej 3 anëtarëve në këtë përbërje:

1. **Besartë Musliu- Spahija – Kryesuese e Komitetit,**
2. **Arbresha Syla – Eksperte e Jashtme,**
3. **Gëzim Haxhiu– Anëtarë,**

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin, sot pra e kemi lënë me vizitu QKMF-në, nuk e di a kemi mundësi.

z.Hasan Avdyli; Unë e kisha lënë për ndonjë ditë tjetër.

z.Gëzim Haxhiu; Unë jamë për me shty pasi që edhe Hasani qenka për me shty.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Propozoj që në mbledhjen e radhës të diskutojmë për terminin e vizitës në QKMF. Pasi që diskutuime tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 09:40h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit
Besartë Musliu-Spahija

